

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI BASHKIAK  
LUSHNJE**

**VENDIM**  
Nr 30 date 16.05.07

**Mbi miratimin e projektit te Festivalit Folklorik Tipologjik Kombetar I  
Valles Popullore "Lushnje- qershor 2007".**

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 16.05.2007 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kultures mbi miratimin e projektit kulturor-artistik "Festivali Folklorik Tipologjik Kombetar I Valles Popullore –Lushnje – qershor - 2007" bazuar ne V.K.M Nr. 309 date 21/06/1993 "Mbi shperblimin e cilesise artistike " – dhe me V.K.M Nr.441 date 15/08/1994 pika 10,3 "Mbi detyrat e Seksionit te Kultures " si dhe duke u mbeshtetur ne Ligjin Nr. 8652 date 31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" – Kreu IV neni 10, pika II germa a:

**VENDOSI :**

Te miratoje projektin kulturor – artistik te paraqitur nga Drejtoria e Kultures :

1. – "Festivali Folklorik Tipologjik Kombetar I Valles Popullore –Lushnje – Qershor - 2007"- me shumen 1.800.000 leke e cila do te mbulohet nga buxheti Bashkise nepermjet Drejtorise se Kultures dhe Drejtorise se Financave.
2. – Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kultures dhe Drejtoria e Finances – Bashkia Lushnje.

**KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK  
VASILIKA HOXHA**

